**KONTRATË**
**SHITBLERJE (TRANSFERIM) AKSIONESH**

E lidhur sot me datë 27 Qershor 2022 , ne Rrëshen në mëes të mëposhtëshenuarve:

a) **SHITËSI**
**Përparim Përkeqi**, i biri i Prengës dhe Lizës , lindur në Kurbnesh Mirditë më 14.06.1969, banues në Rrëshen Mirditë, shtëtas Shqiptar , Me Nr. ID G90614027M, Nr. Kartë ID 036223417, aksioner i Shoqërisë Tregtare “Pi.Bi.Pi” sh.p.k, zotërues i 49 % të aksioneve të kësaj shoqërie , e barabartë me një kuotë me vlerë 73.500 lekë.

b) **BLERËSIT**
**B1. Nensi Bita**, e bija e Apostol dhe Lindita, lindur në Lushnje më 27.10.1993, banues nëe Tiranë, Me Nr. ID J36027032M, Nr. Pasaportë BC0501300.

**B2. Preng Përkeqi** i biri i Bibës dhe Mrikës, lindur në Kumbull Mirditë më 10.06.1938, banues në Rrëshen Mirditë, shtëtas Shqiptar , Me Nr. ID D80610070N, Nr. Kartë ID 034103699, aksioner i Shoqërisë Tregtare “Pi.Bi.Pi” sh.p.k, zotërues i 30 % të aksioneve të kësaj shoqërie, e barabartë me një kuotë me vlereë 45.000 lekë.

Të cilet bënë hartimin e kesaj kontratë shitje (transferim) aksionesh , në bazë të Ligjit 7638, datë 19.11.1992 ”Për Shoqëritë Tregtare“, dhe me vullnetin e tyre të lirë

Shoqëria Tregtare “Pi.Bi.Pi” sh.p.k me Nr. NIPTI- L29506001P, seli në Pallati Nr.7, Shkalla Nr.1, kati 2, Apartamenti Nr.2. Rrëshen, Mirditë, është themeluar me datë 06/09/2012 me kapitali themeltar 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë lekë), me vlerë nominale aksioni 1.500 lekë ne të cilen aksioneret marrin pjese si me poshtë:
**PËRPARIM PËRKEQI** zotërues i 49% të aksioneve të kësaj shoqerie e barabartë me 1 kuotë, me 49 aksione, me vlerë 73,500 lekë (shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind lekë)
**PRENG PËRKEQI** zotërues i 30% të aksioneve të kësaj shoqërie barabartë me 1 kuotë, me 30 aksione me vlerë 45,000 lekë (dyzet e peseë mijë lekë)
**VERONIKA CARA** zotëruese e 7% të aksioneve të kesaj shoqerie e barabartë me 1 kuotë, me 7 aksione me vlere 10,500 lekë (dhjetë mijë e pesëqind lekë)
**ALBINA PRENDI** zotëruese e 7% të aksioneve të kesaj shoqërie e barabartë me 1 kuotë, me 7 aksione me vlere 10,500 lekë (dhjetë mije e pesëqind lekë)
**NORA PALOKAJ** zotëruese e 7% të aksioneve të kesaj shoqerie e barabartë me 1 kuotë, me 7 aksione me vlere 10,500 lekë (dhjetë mije e peseqind lekë )
Me vendimin Nr. 1/27 datë 27 Qershor 2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerve është miratuar shitja e aksioneve të Perparim Perkeqit , dhe blerja e tyre nga aksionerët Nensi Bita dhe Preng Përkeqi

Shitësi Përparim Përkeqi, deklaron pa asnje pengesë , në pronesi dhe zotërim të plotë, sasinë e aksioneve që pershkruhen holësisht më sipër , në shoqërine Tregtare "Pi.Bi.Pi" shpk me seli në Pallati Nr.7, Shkalla Nr.1, kati 2,Apartamenti 2. Rreshen, Mirdite.

Përparim Përkeqi me vullnet të lire dhe të plotë se bazuar ne të drejtën qe buron prej tyre, dhe të drejtën qe ai ka mbi to, ai i shet me transferim 49% të aksioneve të kësaj Shoqërie, 1 kuotë , me vlerë 73,500 lekë (shtatëdhjetë e tre mije e peseqind lekë), duke ja kaluar në pronësi dhe zotërim të plotë , karshi shumës së blerjes të gjithe të drejtat dhe detyrimet , aktivin dhe pasivin qe buron nga ky kapital,

Bleresit Nensi Bita, karshi shumes 45,000 lekë (dyzet e pesë mijë lekë) , shume të cilen e ka shlyer plotësisht, dhe që i përgjigjet 30 % të vleres se aksioneve.

Bleresit Preng Përkeqi, karshi shumes 28,500 lekë (njëzet e tetë mijë e pesqind lekë) , shume të cilen e ka shlyer plotësisht, dhe qe i përgjigjet 19 % të vlerës së aksioneve.

Keshtu shitësi Përparim Përkeqi heq dorë nga cdo titull dhe e drejtë lidhur me zotërimin e aksioneve të mesipërpermendura dhe njeh dhe emeron "bleresit" Nensi Bita dhe Preng Përkeqi pronar dhe zotërues të atyre aksioneve.

"Shitësi", nepermjet kësaj dkontratë shitje aksionesh garanton si më poshtë :

1) Të gjitha aksionet e lartpermendura të "shoqerise", dhe të transferuara, jane të lira nga cdo barre, huamarrje , konfiskim , pretendime personash të tretë , gjithashtu garanton aksione të lira nga cdo detyrim ligjor.
2) "Shitësi" kalon tëk "bleresit" tëresisht 49% (dyzet e nëntë) të kapitalit aksioner të "shoqerise" ne vleren 73,500 lekë

Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate Bleresit

Nensi Bita behet pronar, zotërues i 30 % të aksioneve të kesaj shoqerie , e barabartë me 30 aksione , me vlere 45,000 lekë (dyzet e pesë mijë lekë) , dhe

Preng Përkeqi behet pronar, zotërues i 19 % të aksioneve të kesaj shoqerie , e barabartë me 19 aksione, me vlere 28,500 lekë (njëzet e tetë mijë e pesqind lekë), (këto vetëm nga shitja e aksioneve të z. Përparim Përkeqi pa përfshirë aksionet e tij si ortak I shoqërisë)

Shitësi Perparim Perkeqi nuk ka asnje të drejtë mbi aksionet e kësaj shoqërie pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

Kjo kontatë shitje aksionesh hartohet në katër kopje të njëjta dhe nënshkruhet si më poshtë

| **Shitësi i Aksioneve** | **Bleresit e Aksioneve** | |
|---|---|---|
| **PËRPARIM PËRKEQI** | **PRENG PËRKEQI** | **NENSI BITA** |
| Përparim Përkeqi | PRENG PERKEQI | NENSI BITA |